



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

***RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TE BUXHETIT
PER 8-MUJORIN JANAR - DHJETOR 2023***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Agjencia e Shërbimeve Publike menaxhon buxhetin e saj , në dy programe:

1. **Programi 4520:** Rrjeti rrugor rural.
2. **Programi 6260 :** Shërbimet publike vendore

Realizimi i shpenzimeve sipas dy programeve kryesor, krahasuar me planin e 12–muorit 2023 rezulton si më poshtë:

000 leke

Emërtimi i shpenzimit	Plan vjetor 2023	Buxhet 2023	Plan 12/mujor 2023	Buxhet 2023	Realizimi 12-mujor Janar – Dhjetor 2023	% e realizimit
600+601		103,630		103,630	95,129	91.80%
602-609		178,063		178,063	137,888	77.44%
230-231		3,973		3,974	3730	93.86%
Totali		285,666		285,667	236,748	83%

Plani sipas programeve për vitin 2023

000 leke

Emri i Grupit	Agjencia e Shërbimeve Publike							Kodi i Grupit
Programi	4520/6260							Kodi i Programit
Titulli	Emertimi Programit	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2022	(2) PBA Plan Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/4 mujori	(6) Fakti Periudhes/4 mujori	
4520	Rrjeti rrugor rural	103,412	83,856	83,856	140,041	140,041	108,042	
6260	Shërbimet Publike	114,443	142,474	142,474	143,590	145,652	128,706	
	Totali	217,855	226,330	226,330	283,631	285,693	236,748	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

PROGRAMI 4520 RRJETI RRUGOR RURAL.

Përshkrimi Përgjithshëm i Programit

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04520	Rrjeti rrugor rural	<ul style="list-style-type: none">• Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore;• Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore;• Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin		<ul style="list-style-type: none">• Agjencia e Shërbimeve Publike (për shpenzimet korrente)

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit të ndicimit publik. Mirëmbajtja e rrugëve rurale.

- Ofrimi i një shërbimi cilesor në mirëmbajtjen e rrugëve urbane, trotuarëve, sinjalistikës rrugore si dhe sistemit të kanalizimit të ujrave të bardha, mirëmbajtjen e trotuarëve, kalldre ekzistuese si dhe shtimin e sipërfaqeve të reja.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

- Ofrimi i një shërbimi cilësor në mirëmbajtjen e rrugëve rurale.

Sipas ndarjes ekonomike paraqet këta tregues të përmbedhur të realizimit të buxhetit:
000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2023	Plan Buxhet 12/mujor 2023	Realizimi 12- mujor Janar –Dhjetor 2023	% e realizimit
600+601	28,592	31,120	30,390	98%
602-609	108,764	108,921	77,652	71%
230-231	-	-	-	
Totali	137,356	140,041	108,042	77%

- Artikulli 600 + 601 : Paga dhe sigurime - është realizuar në masën 98 % e planit 12-mujor. Shpenzimet për paga të planifikuara për vitin 2023 janë 30,390 mijë lekë. Pagat e të gjithë punonjësve janë paguar rregullisht çdo muaj sipas prezencave respektive në njësitë shpenzuese.
- Shpenzime operative (art. 602-609), janë planifikuar në shumën 108.764 mijë lekë dhe është realizuar në masën 71% të planit 12- mujor.
- Nuk është realizuar kontrata për “Blerje material asflat”, pasi është transferuar në vitin 2024 për arsye të amendimit për kushte të papërshtatshme të motit për shtrimin me asfalt të rrugëve urbane dhe rurale.

Shpenzimet korrente u kryen për të realizuar produktet:

I . Mirëmbajtja e Rrugëve rurale dhe urbane .

1. Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara, duke vendosur puseta. Këtu do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojës dhe kërkesave të banorëve.

Gjatësia totale e rrugëve në të gjithë territorin e Bashkisë Berat është 857 km, ndër të cilat 615 km janë rrugët rurale dhe 242 km janë rrugët urbane.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Sipërfaqja totale e rrugëve është 857 323 m² në të gjithë territorin e Bashkisë nga të cilat janë të trajtuara me asfalt dhe 2800 m² dhe me stabilizant 4200 m².

Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve të ujrave të bardha , të larta dhe i pusetave .

PUNIMET ME KRYESORE TË REALIZUARA PËR VITIN 2023

• **Mirëmbajtje dhe rehabilitim të rrugëve Rurale dhe Urbane si shtrime me material asfalti.**
Në bashkinë e Beratit gjatë vitit 2023 janë realizuar punime për sistemimin e rrugëve rurale dhe urbane , shtrim me asfalto beton, 30.000 m² si më poshtë

Rajoni Nr 3

Uznovë Rr Rilindasit 5.000 m², Qemal Stafa 1200 m², Driloni 850 m² , Bllok pallatesh 1.200 m².

Rajoni Nr 1,

Dëshmorët e Kombit 1.250 m², Sheshi Barrikad 3000 m², Rruga Agron Elezi 3000 m²

Njësia administrative Otlak ,

Rruga Parangoi 1650 m² , Rruga Ushqimores 4.000 m² , Rrugë të brendshme fshati Dyshnik 4.000 m², Rrugë të Brendshme shkolla Irfan Ngjeqari 4.500 m² , Fshati Otlak 3.500 m²

• **Mirëmbajtje e Rrugëve Rurale dhe Urbane me Beton**

Në bashkinë Berat gjatë vitit 2023 janë realizuar punimet e mirëmbajtjes së rrugëve me beton rreth 2.000 m² si më poshtë :

- Në fshatin Lapardha 400 m².
- Në fshatin Drobonik 380 m².
- Në fshatin Veleshnjë 460m² .
- Në fshatin Mbreshtan 400 m².
- Në fshatin Kamçisht 170 m².
- Në rrugën Gaqi Gjika 160 m² .

• **Mirëmbajtje dhe rehabilitim të rrugëve Rurale dhe Urbane çakull**

Mirëmbajtje e rrugëve me çakull në cdo njësi administravtive atje ku problematika e banorëve të zonës si dhe në bazë të kërkesave të Administratorëve të njësivë .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

- Njësia Administrative Sinjë
- Njësia Administrative Velabisht
- Njësia Administrative Roshnik
- Njësia Administrative Otlak

- **Ndërtimi I murit mbajtës në rrugën Gaqi Gjika rreth 25 m³.**
- **Ndërtimi I Urës Gjeroven**

Programi 6260 Shërbimet Publike .

Përshkrimi Përgjithshëm i Programit

Veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e jetesës.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
06260	Shërbimet Publike	Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbër të njesisë së vetëqeverisjes vendore; Shërbimi i dekorit të qytetit në raste festash Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike dhe të dëshmorëve, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore; Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit rrugor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Njësia Shpenzuese që
menaxhon programin

• Agjencia e Shërbimeve Publike (për
shpenzimet korrente)

Sipas ndarjes ekonomike paraqet këta tregues të përmbedhur të realizimit të buxhetit:
000/ leke

Emertimi i shpenzimit 06260	Plan Buxhet vjetor 2023	Plan Buxhet 12/mujor 2023	Realizimi 12- mujor Janar –Dhjetor 2023	% e realizimit
600+601	74,105	75,512	64,739	86%
602-609	67,550	69,167	60,236	87%
230-231	1,573	3,973	3731	94%
Totali	143,228	148,652	128,706	87%

Artikulli 600 +601 : Paga dhe sigurime - është realizuar në masën 86% e planit 12-mujor. Shpenzimet për paga të planifikuara për vitin 2023 janë 75,512 mijë lekë.

Pagat e të gjithë punonjësve janë paguar rregullisht çdo muaj sipas prezencave respektive në njësitë shpenzuese. Mos realizimi I planit për arsye të vendeve vakante të punonjësve.

Shpenzime operative (art. 602-609), janë planifikuar në shumën 69,167 mijë lekë dhe është realizuar në masën 87 % të planit 12 mujor. Mos realizimi vjen për arsye të kontratës me afat 1- vjecar të Blerje Karburant dhe për arsye uljes së ofertave ekonomike më poshtë se fondi limit të operatoreve ekonomik në proçedurat e prokurimeve publike.

Janë likuiduar të gjitha faturat si Energji Elektrike , Ujësjellës Kanalizime dhe Internet dhe nuk kemi asnjë faturë të prapambetur.

Detyrimet e prapambetura të Energjisë Elektrike të viteve të mëparshëm sipas akt-rakordimet dhe shlyerjeve të bëra deri më datën 30.04.2023 sipas Udhëzimit të MF ka përfunduar .

Artikulli 230-231 Për 12- mujorin 2022 . Kemi realizuar investime si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Kontraktuar	Plani i buxhetit viti _2023	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-M/2023)
		e projektit	të projektit	të projektit				
1020180	Blerje peme dekorative	754	2022	2023	po	754	754	754
1020020	Blerje pajisje ,instru vengla pune	820	2023	2023	po	820	645	645
1020210	Hidroizolim I Terraces së varrezave	1,200	2023	2023	po	1,200	1109	1109
1020211	Blerje shtepizash per festat	1,200	2023	2023	po	1,200	1104	1104
	Blerje pajisje kompjuterike	174	2023	2023	po	174	117	117

II Objektivat e Programit për këtë 12- mujor Sektori i Ndricimi Publik

Objektivat e Programit

- Ofrimi I një shërbimi cilësor në mirëmbajtjen e rrjetit te ndriçimit rrugor për rajonet dhe njësitë administrative, të mirëmbahet rrjeti ekzistues i ndiçimit publik dhe të mundësohet mbulimi i zonave të reja me ndiçim.

Produktet që synohen të ofrohen

I. Mirëmbajtja e ndriçimit rrugor

- Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët të cilat kanë pasur ndriçim rrugor, por sot nuk funksionon për shkak të dëmtimit të rrjetit, ku parashikohen punimet për vendosjen e koka ndriçuesi ose llamba, rrjeti kabllor i nevojshëm, etj.
- Programe manaxhimi dhe ekonomizimi të energjisë elektrike nëpërmjet zëvendësimit të llampave ekzistuese me llampa led.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Gjatë vitit 2023, sektori elektrik pranë Agjensisë së Shërbimeve ka kryer 195 punime me urdhra pune. Këto punime janë kryer gjatë evidentimeve të problemeve që kanë konstatuar punonjësit dhe kërkesat që vinë nga qytetarët.

Shpërndarja e këtyre punimeve sipas rajoneve dhe njësive administrative janë si më poshtë:

1. Rajoni Nr.1 janë 59 urdhra pune

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues led 100ë	copë	31
2	Krah alumini	copë	31
3	Llampa (18,40,125,150,250ë)	copë	307
4	Drozel (70,150,250ë)	copë	85
5	Injektor	copë	57
6	Kabull 2x2.5mm ²	ml	575
7	Tel fi(1.5,2.5,4)	ml	910
8	Prozhektor (30,50ë)	copë	4
9	Automat,lëshues	copë	21

2. Rajoni Nr.2 janë 75 urdhra pune

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues led 100ë	copë	49
2	Krah alumini	copë	19
3	Llampa (18,40,125,150,250ë)	copë	626
4	Drozel (70,150,250ë)	copë	126
5	Injektor	copë	90
6	Kabull 2x(1.5,2.5,4,6)mm ²	ml	1600
7	Tel fi(1.5,2.5,4)	ml	1100
8	Prozhektor (30,50ë)	copë	55
9	Automat,lëshues	copë	70

3. Rajoni Nr.3 janë 30 urdhra pune

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues led 100ë	copë	22
2	Krah alumini	copë	10
3	Llampa (18,40,125,150,250ë)	copë	180



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

4	Drozel (70,150,250ë)	copë	154
5	Injektor	copë	64
6	Kabull 2x(1.5,2.5,4,6)mm ²	ml	330
7	Tel fi(1.5,2.5,4)	ml	820
8	Prozhektor (30,50ë)	copë	4
9	Automat,lëshues	copë	27

4. Në Njësinë administrative Velabisht janë 8 urdhra pune

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues led 100ë	copë	26
2	Krah alumini	copë	26
3	Tel fi(1.5,2.5,4)	ml	1690

5. Në Njësinë administrative Rroshnik janë 7 urdhra pune

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues led 100ë	copë	4
2	Krah alumini	copë	4
3	Llampa (18,40,125,150,250ë)	copë	38
4	Drozel (70,150,250ë)	copë	5
5	Injektor	copë	6
6	Kabull 2x(1.5,2.5,4,6)mm ²	ml	160
7	Tel fi(1.5,2.5,4)	ml	200
8	Automat,lëshues	copë	11

6. Në Njësinë administrative Sinjë janë 11 urdhra pune

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues led 100ë	copë	5
2	Krah alumini	copë	4
3	Llampa (18,40,125,150,250ë)	copë	68
4	Drozel (70,150,250ë)	copë	40
5	Injektor	copë	27
6	Kabull 2x(1.5,2.5,4,6)mm ²	ml	100
7	Tel fi(1.5,2.5,4)	ml	900
8	Automat,lëshues	copë	9

7. Në Njësinë administrative Otlak janë 5 urdhra pune

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues led 100ë	copë	2
2	Krah alumini	copë	2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

3	Llampa (18,40,125,150,250ë)	copë	29
4	Drozel (70,150,250ë)	copë	13
5	Injektor	copë	27
6	Kabull 2x(1.5,2.5,4,6)mm ²	ml	20
7	Tel fi(1.5,2.5,4)	ml	50
8	Automat,lëshues	copë	9

Përfshihet mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor ekzistues ku përfshihen punimet për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët e qytetit dhe fshatrat , riparime ditore, si rezultat i dëmtimeve dhe defekteve në linjat përkatëse, që kap një gjatësi të ndicuar prej 46.4 km .

III .Objektivat e Programit për këtë 12- mujori 06260 Sektori i Gjellberimit dhe mirëmbajtja e varrezave publike

Sektori I Gjellberimit për 8-mujorin e vitit 2023

Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve mjedisore dhe hapësirave të perbashketa komunitare sa më të këndshme dhe funksionale, sipas standarteve bashkëkohore , krijimit të një ambienti shlodhës dhe argëtues për të gjalleëruar jetën komunitare dhe kohezionin social.

Objektivat e Programit për këtë 8 mujor :

- Përmirësim i cilësisë së mirëmbajtjes dhe gjellberimit rrugor, në të gjithë territorin e Bashkisë.
- Përmirësimi i cilësisë së mirembajtjes dhe estetikës dhe kushteve të argëtimit për fëmijet e familjet
- Përmirësimi i cilësisë së mirmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në përputheje me planin kalendarik sektori i Gjelbërimit ka realizuar punimet duke mirëmbajtur një sipërfaqe me rreth 87.394 m² nga ku kemi një sipërfaqe me tapet bar rreth 57.686 m², 5.570 rrënjë drurë dekorativ: qyteteti I Beratit ka një sipërfaqe të gjelbër që trajtohet si shërbim komunitar dhe plotëson normën 4-5 m² për banor. Duke marr në konsideratë kurorat që rrethojnë qytetin, oborret private dhe sipërfaqet e gjelbra të instucioneve në qytetin tonë kjo normë arrin në 20-25 m² për banor.

- Pastrimi i sipërfaqeve të gjelbra është bërë në mënyrë sistematike, ujitja e tapeteve të barit.
- Janë kryer krasitjet, punimi dhe shërbimet fitosanitare e drurëve dekorativ.
- Sektori I Gjelberimit ka vendosur 100 stola të rinjë në parqet e qytetit, në Pedonale, Dëshmorët e Kombit dhe në lulishten Çlirim.
- Janë vendosur kosha të rinjë me kapacitet 10 kg në Pedonalen e qytetit dhe në segmentin Stadiumi i Vjetër –Stadium I Ri.
- Janë kryer shërbimet në sipërfaqet e mbjella me lule sezonale, kositja e barit.
- Mbajtja dhe sistemimi nëpërmjet krasitjes I bordurave dhe kacubeve.
- Shërbimet gjatë vitit 2023 nga sektori i Gjelbërimit janë zhvilluar edhe në ambientet e shkollave të lagjeve të brendshme të qyteti dhe njësive Administrative.

1. Treguesit te performancës në nivel rezultati (objektiva)

- a. Kemi realizuar objektivat në masën 100% duke përmiresur cilesinë dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelberta me lule, trëndafila, peme dekorative, etj.

SEKTORI I MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE

Duke filluar nga data 17.01.2022 punimet e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të Dëshmorëve kaluan nën administrimin e Agjensisë së Shërbimeve Publike nëpërmjet, Sektorit që mbulon mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të Dëshmorëve si edhe shërbimin e varrimit.

Paraprakisht, me subjektet funerale që operojnë në Njësinë Administrative Berat (“ABZOGA”shpk; “EMILIANO CO”shpk; “KEJSI@NIKU”shpk dhe “TOM CAPI”shpk) u lidhen kontrata me Agjensine e

Ndërsa vlera e shërbimeve të varrimit për periudhën Janar- Dhjetor 2023 është:

a. Varrime me varre te rinj

285 x 16160 leke = 4605600 leke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

b.Varrime me zhvarrim me qivure	58 x 28588 leke = 1658104 leke
c.Varrime me zhvarrim pa qivure	36 x 18222 leke = 655992 leke
d.Zhvarrim eshtra me qivure	6 x 16422 leke = 98532 leke
e.Zhvarrim eshtra pa qivure	3 x 5978 leke = 17934 leke
f.Zhv eshtra me qivure dhe rivarr eshtra me varr te ri	1x(16422+16160) = 32582 leke
g.Zhv. eshtra me qivure dhe rivarrim eshtra	1x(16422+9938) = 26360 leke
h-zhvarrim pa qivure plus vendosje eshtra	1x16422 leke = 16422 leke
i-varrim eshtra me varr te vogel	1x9938 leke = 9938 leke
j-zhvarrim pa qivure plus varrim me varr te ri	1x(5978+16160) = 22138 leke
k-Zhv eshtra me qivure+varr me zhv me qivure	(1x16422)+(1x28588) = 45010 leke

Totali i vlerës së shërbimeve të varrimit për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 është 7188612 lekë

Pë periudhën 01.01.2023-31.12.2023 nuk është bërë pagesa për të ndjerën Reshide Nexhip Brahimaj, për të ndjerën Pranvera Berisha dhe për të ndjerën Miranda Stoceni , pasi me urdher te Z. Piro Xheblati, këto tarifa, me vlerë 48480 lekë mbulohen nga shpenzimet e Bashkise Berat.

Gjithashtu, nuk është bërë pagesa për të ndjerën, Sajde Kanani, nga familjarët (ky shërbim është realizuar nga subjekti funeral “Tom Capi”shpk, tek i cili nuk janë paraqitur familjarët e së ndjës për të paguar tarifën e shërbimit).

Materiale të harxhuara për periudhën 01.01.2023-31.12.2023:

1-Pllaka varri prej betoni	sete = 382.5
2-Tabela (koka varri) metalike	cope =383
3-Kellef bezeje	cope = 110
4-Pleh kimik	kg = 25
5-Detergjente	litra = 5

Nga data 01.01.2023 deri me 31.12.2023 jane perdorur 382.5 sete pllaka varri.

Me poshte po paraqesim dinamikën e shërbimeve të varrimit (**numëri i vdekjeve**) për periudhën 2019-2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Muaji	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Janar	37	43	52	43	42
Shkurt	44	36	46	43	35
Mars	31	28	47	39	22
Prill	22	30	40	27	28
Maj	32	28	39	30	25
Qershor	40	28	32	29	35
Korrik	31	45	34	42	39
Gusht	30	30	41	31	36
Shtator	26	27	34	18	23
Tetor	31	49	56	27	35
Nentor	28	63	41	18	28
Dhjetor	34	78	57	25	29
Shuma	386	485	519	372	377

Pra, sic shikohet nga kjo tabele, dinamika e personave të vdekur për vitin 2023 është rritur me 5 persona, krahasuar me vitin 2022.

B. Mirëmbajtja e varrezave publike dhe të Dëshmorëve.

Përsa i përket mirëmbajtjes së Varrezave Publike dhe të Dëshmorëve, për periudhën që trajtojmë rëndësi i është dhënë shërbimit 24 orësh në varrezat e Dëshmoreve, të cilët krahas shërbimit të rojes realizojnë kontaktin me operatorët funerale, me të cilët komunikojmë për të dhënat e personave të vdekur, si edhe caktojme ditën, orën dhe vendin ku do të kryhet shërbimi i varrimit, duke bërë menjëherë njoftimin e puntorëve të varrimit të cilët sipas llojit të shërbimit kanë marrë masa që shërbimet të kryheshin pa ndonjë rast ankese. Në këtë varrezë është bërë prashitja e parcelave me kazem, është bërë shkulja e barit, është bërë krasitja e e ligustrave qe rrethojnë varrezat e Dëshmorëve dhe bimëve të tjera decorative, të shperndara nëpër parcela, u bë dizinfektimi i trendafilave me insecticide kunder morrit, u bë prerja e barit përreth lapidarit dhe nëpër parcela, si edhe u bë zëvendesimi I kater kokave të varrit të cilat ishin të dëmtuara duke bërë shkrimin e emrave të dëshmoreve.